



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI

Nr. 1871 / Prot. 19

Tiranë, më 29.10.2018

UDHËZIM

Nr. 3 datë 29.10.2018

**PËR
REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE NË KUOTAT E PAPLOTËSUARA NË
PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË NË FAKULTETIN E
MJEKËSISË DENTARE, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, 2018-2019**

Në zbatim të Udhëzimit nr. 18, datë 21.05.2018 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2018-2019” të MASR, i ndryshuar, për procesin e regjistrimeve në kuadër të plotësimit e kuotave të mbetura bosh sipas programeve të studimit,

UDHËZOJ:

1. Kandidatët të cilët nuk janë të regjistruar në një program studimi në raundin e parë apo të dytë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare, kanë të drejtë të aplikojnë në kuotat e paplotësuara, përkatësisht 1 kuotë në programin “Bsc” në “Teknik Dentar” dhe 1 kuotë në programin “Bsc” në “Higjienist Dentar”.

Kërkesat për aplikim dorëzohen pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit të Mjekësisë Dentare, në datat 29 tetor deri më 02 nëntor 2018, nga ora 8:00 deri në 16:00.

- 1.1. Kandidatët që kanë qenë aplikantë në raundin e parë apo të dytë në programet e studimit të UMT, paraqesin kërkesën me shkrim për aplikim si dhe deklaratën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
- 1.2. Kandidatët që aplikojnë për herë të parë në programet e studimit të UMT, duhet të paraqesin:
 - Kërkesën me shkrim për programin në të cilën aplikon;
 - Kopje noterizuar e diplomës dhe certifikatës së maturës shtetërore
 - Deklaratën nr. 1, si dhe deklaratën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi
2. Komisioni i posaçëm i ngritur pranë FMD, pjesë e të cilit do të jetë edhe një përfaqësues i Komisionit të Monitorimit, ngritur me Vendim Rektoratit nr. 7, datë 02.07.2018, bën renditjen e aplikantëve dhe brenda datës 04 nëntor 2018, shpall listat e renditura në ueb-in e fakultetit dhe UMT-së, si dhe në vende të dukshme në godinën e FMD-së.

3. Nga data 05-07 nëntor 2018 vijon procesi i regjistrimit me faza 1 orëshe, duke i dhënë mundësi kandidatit vijues për vazhdimin e procesit nëse kandidati paraardhës nuk paraqitet për regjistrim brenda fazës përkatëse një orëshe.
4. Brenda datës 08 nëntor 2018, FMD duhet të përcjellë në Rektoratin e UMT-së, listat me personat e regjistruar.
5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Fakulteti i Mjekësisë Dentare.

REKTORI

Arben GJATA

